

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Shko pi kafe"/ Këshilla e Berishës për ministren e Shëndetësisë
ADRESA	https://www.cna.al/politike/shko-pi-kafe-keshilla-e-berishes-per-ministren-e-shendetesis-e-i474456
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:10:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 11:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9c365fb11de47cd94cc8235d18350273717aa1125105070f568018e42c18ab27
TEKSTI	304aff0dcbf88666d171bcdaf178b8580c5c89f966c55739668d01e17c99a781
PAMJA	0e9a5609934638083b895e2d8903acff0584db69166a5aee40aeb579307d06ce

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2a097169e06ecfd2c5967126425e0bee7ca17afdb8576f4799e24cfa4e9a2a6b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2a097169e06ecfd2c5967126425e0bee7ca17afdb8576f4799e24cfa4e9a2a6b

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

13:56 Politikë

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka marrë fja...

“Shko pi kafe”/ Këshilla e Berishës për ministren e Shëndetësisë



17 Shtator 2026, 13:56, Politikë CNA



Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka marrë fjalën në Kuvend, pas interpelancës me ministren e Shëndetësisë, Klodiana Spahiun.


Berisha u shpreh se paraardhësja e saj, Evis Sala, dha dorëheqjen sapo iu propozua ajo që ai e cilësoi si "skema e vjedhjes më të madhe të të sëmureve".

Më tej kryedemokrati kishte dhe një këshillë për ministrin, e cila ishte, të pinte kafe me Mirlinda Karçanajn.

Ndër të tjera, ai tha se Spahiu nuk duhet të dalë dhe të mbrojë skandalet e ndodhura në shëndetësi para se ajo të merrte detyrën.

"Kësaj zonje që ikën kështu dhe që u betua dhe u stërbetua këtu, duhet t'i them dy fjalë. Pararendësja juaj, ajo ka qenë një studiuese e rrallë, ua them unë, me punime që po t'u marrësh ju të gjithëve së bashku, nuk bëni as një të dhjetën e saj. Në Kembrixh dhe në universitete të tjera. Në një moment të caktuar, kur thoni ia mori ai mendjen dhe pranoi detyrën e ministres. E vërteta, me dorëheqjen e saj, ajo mbrojti integritetin e vet, duhet ta them, pavarësisht nga akuzat e lëshuara mbi të, por ajo kur erdhi puna që iu propozua skema e vjedhjes më të madhe të të sëmureve, ajo tha mirupafshim. Pasardhësja u betua, u stërbetua këtu, kam vetëm një këshillë, shko dhe pi një kafe, jo me Lindën e Surrelit, por me Lindën tjetër. Jo me patronazhistin, por me atë drejtoreshën dhe të të rrëfejë ajo dramën e saj në mënyrë që uroj të mbledhësh mendjen dhe të japësh dorëheqjen një minutë e më parë nga ajo detyrë se fillim më të mbrapshtë nuk mund të kishte se të fusje aty patronazhistin e Surrelit, Lindën e Surrelit, kunati i së cilës është faktikisht strumbullari i të gjithë vjedhjeve të qindra miliona eurove në AKSHI.

Dhe nuk i del emri vetëm se është kunati i Lindës. Pra, meqë the për disa të dhëna, unë t'i jap ty të sakta fare. Pa dyshim që sistemi shëndetësor gjithnjë ka nevojë shumë të madhe për t'u përmirësuar, por një gjë kishte, në ato vite Shqipëria renditej e treta në Europë për aksesin, pra për mungesën e radhës. Së dyti, nuk kishte mungesa ilaçesh për sëmundjet malinje sepse në mënyrë absolute u bliheshin me çdo kusht. Së treti, një sistem mbi 100 milionë euro u investua në imazheri. Pra, nuk them se nuk kishte të meta, por statistikisht tregojnë se sot shqiptarët paguajnë 50 për qind më shumë nga xhepi nga sa paguanin në ato vite. Mos bëj avokatinë e atyre akteve të tmerrshme, ku sterilizimit iu rrit çmimi 83 herë. Ndaj dhe je shumë folklorike kur del e betohesh këtu se je transparente. Po si mund t'i dalësh ti zot këtu sterilizimit? Ka ndodhur si ka ndodhur, po e kanë paguar me qindra jetë. A e di ti sa vdiqën nga Covid-i? 20 mijë vdekje. Shqipëria u ngjiti në çatinë e botës për vdekje. Dhe ti je mjeke, ti e di fare mirë se ajo erdhi nga mashtrimi i të sëmureve, nga një sharlatanizëm kriminal që bëhej çdo gjë për të shtruar të sëmuret dhe mbante Shqipëria gjysmën e shtretërve të Covid-it që kishte Kosova. Pse e lidh veten ti? Pse na bën histori këtu? Ti e ke marrë përsipër aty, vazhdo me tezaken apo dajaken, çfarë është ajo, kushërira e parë, dhe do shohësh vetë ti. Por në radhë të parë shko te Karçanaj dhe pi një kafe me të.", tha Berisha. /CNA





Të sugjeruara

Ministrja Spahiu bën zotim: O sjell PET-Scanin deri në fillim të 2027, o jap dorëheqjen

Debatet PS-PD për vendimin e Hagës/ Ish-deputeti: Eufori për të gjetur tradhtarin, të shihen zgjidhjet

Audio-përgjimet për Ron Yeffet/ Këlliçi në Kuvend: Rama, i përfshirë drejtpërdrejt në trafikun e armëve

Berisha në Kuvend: Rama dhe Vuçiç, përgjegjës direktë për dënimet e Hagës

Rezultatet e PISA-s për arsimin/ Përplasje Boçi-Kumbaro në Kuvend

Shtyhen dy interpelanca në Kuvend/ Ja arsytet

"Doli profecia e Berishës"/ Noka, Ilogari Ramës: Trego pse kërkoje votimin e Gjykatës Speciale

"Rama me avion special për miratimin e Gjykatës Speciale"/ Zhupa përplaslet me socialistët: Jeni krah Vuçiç-it

"Ligji për pagat votohet sot"/ Balla ironizon opozitën: Po reflektoni për sharjet që bëni te dera e SPAK-ut

Projektligji për pagat e magistratëve/ Demokratët: U miratua një version tjetër, të shtyhet miratimi

Nis seanca plenare/ Kuvendi, me deklaratë të përbashkët për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së

VIDEO-Pas vendimit të Hagës/ Deputetët e PD-së hyjnë në Kuvend me simbole të UÇK-së

Konferenca e Kryetarëve/ PD kërkon ngritjen Komisionit Hetimor për KAYO-n, PS e rrëzon

Begaj hedh firmën/ Dekret për shkarkimin e Lamallarit, vjen ministri i ri

"Të vijojnë konsultimet me sistemin e drejtësisë"/ PD kërkon ndryshim të rendit të ditës

E arëta interpellancë në Kuvendin/ Interpelanca me 5 ministër shkarkohen dhe anulohet

E SHËRËMBEDHËTË PËR KRYEQENIN/ TËRËSI PËRSHËRËTË ME 2 NIVELË, SHËRËMBEDHËTË NGA PËRSHËRËTË

“Ripërtëritja e PD-së është jetike”/ Berisha, porosi demokratëve: Duhet të jemi funksionalë

“Foltorja e Ripërtëritjes”/ Berisha prezanton veprimtarinë e re nga Kruja

Kuvendi i PD në Krujë/ Kalaja: Do ta çlirojmë tokën tonë nga kusaria dhe atdheun nga maskarenjtë


EKSKLUZIVE/ Rama drejt Greqisë, ja kush e shoqëron

[editorial](#)

14:40 Editorial Elvi FUNDO

Hashim Thaçi e la Kosovën të lirë/ Erion Veliaj nuk ndahet nga karrigia që i dha PS-ja

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

13:25 Opinione Lutfi Dervishi

Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë

17:17 Opinione Elvi FUNDO

Tirana pa kokë dhe medikamenti i kryeministrit

15:08 Opinione Ardi Stefa

Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë

[Lifestyle](#)

07:38 Lifestyle